

J



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË VIII TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më dt: 04.08.2016 (E enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, Kryetari i Komunës z. Sokol Haliti nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, këshilltarët e Kuvendit, Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Arbresha Ibrahim, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislime Bislime, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Mirlinda Sadiku, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet e shkruara dhe elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Përshëndetje për Kryetari e Komunës, z.Sokol Haliti, Nënkyetarin e Komunës, të gjithë ju Anëtarë të KK-së, Drejtorë e drejtorive si dhe ju të pranishëm, dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e VIII të rregullt të KK-së! Para se të kalojmë në rendin e ditës, më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmuar ligjshmërinë e akteve, të cilët i kemi nxjerrë në Kuvend Komunal, dhe është mirë me ju informu se e kemi konfirmimin nga Ministria e buxheti komunal për vitin e ardhshëm do të pësojë një rritje diku për 600 mijë euro në kategoritë përkatëse si për investime kapitale fale punës së kryetarit i cili ka bërë bashku me stafin e drejtorit përkatëse ka arritur që buxheti për vitin 2017 të ketë një rritje dmth prej diku 600 mijë euro, dhe para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës, si zakonisht në kemi pyetje dhe propozime, fjala është për ju, nëse ka dikush ndonjë pyetje apo propozime.

**z.Adnan Imeri:** Përshëndetje për Kryetarin z.Sokol Haliti, për të pranishmit, unë sot kam një propozim për të cilin kërkoj që të dalë në votim për shqyrtim në seancën e ardhshme i cili është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për banorët e fsh. Sllatin e Epërme, në bazë të

drejtave dhe detyrimeve të këshilltarit të kuvendit komunal, sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunes së Vitise, dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit komunale të Vitise, propozoj që të dal në votim dhe pëe seancen e ardhshme të hyjë si pik e rendit të ditës. Me këtë propozim propozohet të bëhet shpallja e zonave me interes të përgjithshëm për këto parcela: parcela kadastrave me numer 1188-0, zona katastrale Sllatinë, parcela kadastrave me numer 1187-1, zona katastrale Sllatinë, parcela kadastrave me numer 1189-3, zona katastrale Sllatinë, parcela kadastrave me numer 1189-4, zona katastrale Sllatinë, parcelat kadastrave të shpallura zonë me interes të përgjithshëm sipas këtij propozimi kanë për qëllim krijimin e hapësirave të nevojshme me qëllim të shfrytëzimit për projekt të Komunës së Vitisë, mbes me shpres dhe besoj që do të më përkrahni në këtë propozim ju faleminderit.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Pershendetje Kryesuese per të gjithë të pranishmit, se fundi e dime që kompania Ëegener nga Gjermania ka hapur një konkurs per dikun rreth 500 vende të reja të punës e di që është konkus publik mirë po do të dëshiroja qe përparsi te ju jepet sidomos femrave të Komunës së Vitisë me konsultat që kam pas me OJQ-Legjenda ajo deklarajn që i kane te trajnuara dikune rreth 2000 gra dhe meshkuj do të ishte mire që të ju jepet perparsi banorve e sidomos atyre femrave që i përkasin komunes tonë, ndersa pyetja e dyte ka të bëje me ankesat që kane qen diku rreth 44 ankesa në lidhje me emertimin e rrugëve kjo ka ndodhe kogjo moti e është thene që prap do të themelohet një këshill që do ti trajton ato ankesa të këtyre qytetarve mendje kemi pas edhe nje peticion si qe e dim që e kam prezantu në Kuvend do të doja ta di se qka ka ndodhe dhe ku është ky me tutje.

**z.Bekim Azizi:** Pershenderje Kryesues pershendetje per te gjithë të pranishmit, un një pyetje per drejtorin e Inspeksionit lidhje me tregun e kafëshve për shkak smundjes se fundit që ka qen të kafshët pyese se kur do të lejohet tregu u kafeshve.

**z.Sejdi Emini:** Pershendetje per të gjithë të pranishmit un e kam nje shqetësim ketu të taksistat që jane ketu të sheshi është mbajt një panair një dite ketu atyre ju është marr vendet atë ditë dmth ata e kane biznes edhe jane demtuar atë ditë kërkuan që herav tjera mos të ju zënet vendi se edhe ata paguaj tatime ose kur të jav zini vendin është pjesa tjetër aty ka qën dashur me jav siguri që me punu se është dite pune se edhe ata e kan biznes herav tjera me qen të kujdesëshem, kamë edhe një propozim që në shehin e Vitisë të vendosen kamera për shkaqe të sigurise së qytetarve mendoj që ajo bahet me një shume prej 2000-3000€ kjo shume simbolike e ku jane shume të rëndesishme per jeten e qytetarve te komunes së Vitise.

**z.Vebi Rama:** Pershendetje për të pranishmit ne si Komitet per Komitete kemi zhvillu një takim në fsh.Stubëll e Ulet dhe Pozharan, qyshe ne muajin majë kërkoj përgjigjeje se a është vizitu ky komitet Kroat dhe ashkali ne fsh Pozharan dhe Begunce dhe qka është ndërmarr në keto kushte sidomos pëe banimë nga se që janë në gjendje të tmerrshme, pyetja tjetër rruga Rexhep Bislimi që tri vite kerkojn banorët të ju ndertohet kanalizimi e ku ju është premtuar nga Kryetari e ende nuk është filluar asgje e kerkojm pse është bë ku anashkalim, pyetja tjetër sektori i bujqësis edhe pse është i rëndesishem ne komunen tonë si që e dime të gjithë rruga i mungon infrastruktura është fjala per rrugen ish kampi amerikan, ka qën edhe kryetari i ka vizituar po fatkeqësisht nuk është ndermmar asgje pse po anashkalohen kërkesat e këtyre banorve, pyetja tjetër inspektorati i komunikacionit të qëndron në sheshë përball restorantit rio të hurja në shesh jane zebtrat fatkeqësisht që në ato zebra është ballorja që jane të mjellura lule e nuk e di qyshe mujm me ekzistiu edhe lule edhe zebra duhet të jen ja zebtrat ja lulet sepse sun hyet në shesh përshkak të luleve.

**z.Nuredin Lutfiu:** Përshendetje per Kryetarin, Kryesuesin e ju të pranishem, me lejoni që në mer të banorve të fshatit Skifteraj të ju falemenderoj kryetare për nisjen e rregullimit të rrugës në fsh.Skifteraj.

**z.Daut Xhemajli:** Në fillim të viti e kame ngrit dy qështje, njëra per ligjshmerin e statutit të administratës edhe dy Komuna duhet që të ketë një ndërmarrje publike.

**z.Baki Nebiu:** Me ndriçimin publik ne fsh.Kabash a do te rregullohe edhe nese po kur rregullohet pasi që nuk eshte ka funksionon ndriçimi publik në fsh.Kabash.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi qe nuk ka te tjerë për diskutim, ja japim fjalën nënkryetarit, pasi qe u parashtruan disa pyetje.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Fillimisht me lejoi ta përshëndes kryesuesin e Kuvendit, juve këshilltar te nderuar, Drejtoret e drejtorive, shoqëri civile, perfaqesies të OSBE-së, media elektronike e ju të tjerë që jeni prezente në këtë mbledhje, me knaqesin më të madhë e shfrytëzoj rastin me një pjes të pyetjeve te ju jap përgjigjeje, ndersa në pjesen tjeter dikasteret profesional ju përgjigjen pasi që i kemi prezent drejtorë, të pyetja e para me të vertet duhet një pune pak me e madhe, por prona nuk eshte ende e rregulluar eshte në kuadër të ishe nënkompleksi të agro moravës si prone shoqerore udhëhiqet e ka APK-ja nënbikëqyrje ligjet në fuqi jane ata që janë ndersa kërkesat e tona me shkrime rrethe zonave katastrale që jane në interes të komunës kane shku në nivelet qendrore dhe sa pëe informi un thëm se përveq AKP-se zyres regjionale,zyres qendrore ju kame drejtuar edhe Kryeministrisë, Ministris së zhvillimit Ekonomike, Ministris së Financave, dhe Komisionit parlamentar pëe zhvillim Ekonomik, dhe Presidencës, ndersa keto parcela nuk jane vetem të Sllatinës jane edhe të Sadovinës që kemi biseduar pëe zonen ekonomike në disa debate jane pëe pjesen mase Sadovinës të Remniku u Ri 5 hektar që lidhen me zonen katastrale Sadovinën e Qërkezeve dhe jane pjes tjera që me të vertet ne kemi nevoj shume të cilat jane brenda qytetit apo anash qytetit si që jane të vendosura edhe objektet vitale të komunes, duke i përfshi edhe varrezat e stadiumin tregu, zjarrefikset etj, unë jame në koordinim që me instancat qendrore të rrimë në kontakt është mir me e analizu zyra ligjore vendimet që mos të mirren vendime se pëe shkak qe Kuvendi Komunal i cili edhe eshte shperblu per performancen me te mir nga OSBE-ja tash edhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokale, është mir mos me u vnu në lajthitje me bë vendime jo ligjore prandaj është mir me u konsultua me zyrën ligjore, cilat jane të drejtat e tona mirë po ne mundem të vzhillojm debat, mundem të japim rekomandime në mënyre që të i japim mbështetje letrave tona qe i kemi doriu atje, pyetja tjeter të qështja e bashkeunimit dhe tekstili të kompanis Gjermane që ka ardhe si investore, te qështja që me ju dhën përparësi grave ti e shef konkursin se që nga 500 vende të punes 450 flitet që duhet me qën femna, por jane edhe kriteter e konkursit që duhet me i pëefille e ku ne nuk mujm që të nderhyjme jane kriteter edhe profesionale, pyetje ishte te taksistat kjo ka qenë një gjysme dite atë ditë që ishte panairi regjional ka qenë e mbyllur drejtori i bujqësise ka bisedu me taksistit i ka njoftua e ju ka kërku falje un mendoj që eshte e drejt legjitime e komunes kur panairët e tilla regjionale organizohen ku murren pjes dikaster dhe instanca nderkomtare për interes të qtetarve të vitise natyrisht ambienti publik mu shfrytëzu ne momente të caktuar e ku unë besoj që nuk jane demtuar ata per qat kohe dhe ju ka dhëne alternativ se ku mu vendosë keshtu që e di se kam qen i interesuar që me qenë ne rrjedh dhe li njoftu ata me kohe ne mebyr që me u pozicionu me një vend tjeter, kjo rruge është mbyll edhe at ditë që ka qenë ambasadori amerikan e ku është bëëë për qështje të siguris mir po edhe ka qën më i bukur sheshi për tu hecuare edhe ku me ka bë me mendu që per të ardhem ne

basjkepunim me kuvendin me shiku parkingu përrreth parkut ku per kete do te bisedojm me vohen, nje pyetje ishte pëe kamerat ne sheshë eshte terkes legjitime për qeshtje sigurie për interes të të gjithëve por ne do te shikojme në ne ket kuptim kemi hecur shume të kamerat naper shkolla e ne ambiente të tjera edhe ne shpi të kulture ne do të shikojm mundeësi e ku kjo është edhe interes i qytetarve prandaj është kërkes legjitime ku duhet me shti ne plan edhe me bë këtë, të komiteti per komunitete nuk e di angazhim me të madhe pëe komunitetin Kroat , pëe shkalit ne Pozharan nuk jane ata në ambient të keë perkjdesja është e madhe pa dallime sikur për të tjerët komuniteti Kroat kemi pas një vëmendje të veqant si institucione edhe qendrore edhe lokale, Ministria e Mirqenjës Sociale kuzhinen popullore e ka financuar një kohe perveq edhe tjera donator Ambasada Kroate etj por edhe donacione që ka dënë komuna aqe sa kemi pasur mundesi por me rendesi që kemi treguar vëmendje në ndima kohe pas kohe gjithë ashtu edhe përkujdesje të tjera shendetsore, e të shërbimeve publike, ku keme berë rregullimin e ujit ne vendet ku jeton ky komunitet, asfaltimi i rruges ne ne kete kuptim po punojm që atyre ti afrojme kushte me te mira per jetes bilem kan qënë të kënaqur në prononcimet e tyre nëse i keni par, pyetja tjetër ishte kanalizimi të rruga ish kompit te KFOR-it në Viti, jemi duke punuar ne kanalizime edhe lagjore eshte nje projekt që vetem ka shku un sot edhe do te ju informoje jemi tu punu edhe në këtë drejtim më heret edhe nuk kemi mujt se i kemi pasur edhe disa obligime të tjera, as procedurave shume shpejt do ta shihn edhe projekti e kanalizimeve në lagje duke u implementu, do të jetë projekt dy vjeçar e ku do te vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm, të pyetja e Dautit duhet me i nda shërbimet publike në kuptimi e ujit Hidromoraves në kuptimin e kompetencave dhe atë të Ekoigjenes që mirët me këte pjesën tjetër për shkake se Hidromorava është e tjemelume me Ligje tjetër dhe ka kompetenca tjera ndersa të Ekoigjena është partenitet publikoprivat e ketu e kemi një problem krejt tjetër e di kete se jame marr shume me këtë qështje, Ministria e Zhvillimi Ekonomik e ka kërkesen tone un kam zhvilluar takime me zv,Ministrin nga se që Ministri nuk ka pas kohë me na pritë un besoj që shpejt do të na pretë do të shikojm situaten por dhe nje gjë ta kemi të karte tash kompanin Ekoigjena un e kame gjete ne situat me kapacitete të jashtëzakonshme të dobëta, po mendoj operacionalo teknike, gjersa Hidromorava me kapacitetet e veta edhe pse me numer shume të vogel të punetorve është, po funksionon, tash i duhet ndima Komunes un po mendoje në aspekti operaconal teknik me i shtu forcat nders ane aspektet e tjera i vynë ndima edhe e këshillave të fshatrave që me hi, nga se që kemi fshatra që nuk jane ende nën menagjimin e ujit psh Kabashi ende nuk eshte nën hidromorave dhe ka probleme, është mir që me hi nën shërbime pershkake të sigurios së ujit klasifikimi etje, tash kemi me pas fshatra të tjera hidromorava mirret me rivitalizimin e tri ujsjellsave të fshatrave me Zhitin, Skifterajn dhe Beguncën, dmth tash shtohen numeri i fshatrave që ka me hi nënmenagjim tashti i kemi pese fshatra që kemi me diskutu per të cilet pritët me ditë per me u leshu uji, edhe me KEDS-sin jem ormonizu jane rrit kapacitetet e trakes nga 160 në 250 dhe shume shpejt tash e leshojme është djala për Trestenik Sllatinat, Sodovinat, dhe edhe keto jane nën menagjim e kur te kemi parasysh që edhe tri kane me hi në projekt firuesi eshre zgjedhe per Verban e Smire eshte duke u bë projekti per Stubell atëhere del se njëmdhjet fshatra duhet me hi nën menagjimin pa e shti Kabashin e Binçën të cilat nuk janë, në këtë kuptim kapacitetet duhet mu shtu, të ndërhyrja un mendoj që te Ekohigjena mundemi me lete te Hidromorava e kemi pake me veshtir ne kuptimin ligjore, te pyetja e Bakiut të rasti ne Ramjan me keq ardhje e kemi prite at rast pa marre parasysh i kahit është cilies pjes së Kosoves i takone, por është kështu puna fëmija ka qen i Zllatarit dhe zona katastrale ka qenë e

Gjilanit qe është intereson është trekendeshi Gjilan-Viti-Ferizaj aty ajë që e njih atë pjese të Bagdatit dhe prona ka qenë private bilem është prone private të një personit të Gjilanit ku dijet me emer e mbiemër e vitia me pergjegjesi të plote po ta them që Viti me krejt kapacitetet ka intervenua prej policisë, shëndetësis, zjarrëfikësve, kenkyetari, kryesuesi kanë qen prezent këshilltar komunal kemi pas kryetarin e këshillit të fshatit të Ramjanit e vetmja që ka intervenime tanë kapacitetet, të ndriçimi në fashatin Kabash një hër kemi intervenu se është diskutu drejtori i shërbimeve publike duhet mu mar me këtë qështje një qështje është te driëimi publik kompania një ose dy her ka dështuar nuk kane konkurs sa e di un vetem një ka konkurs edhe aj nuk ka ardhe në kuptimi më e nënshkru edhe është ripërserit por drejtorja e shërbimeve publike duhet të mirrt me keq çështje që çdo poq të funksionon, ju falemenderoj të gjithëve për pyetjet e parashtruara.

**Drejtori z.Skender Ahmeti:** Faleminderit kryesues përshëndetje per kryetari ju të pranishem të pyetja e parshtuar nga Bekimi është pyetje me vend nga se që po i shqetson qytetaret por edhe neve si institucion për shkak se e kemi blloku një qështje të ekonomis familjare por ede të ekonomis komerciale qefermeret tan nuk po kan mundesi me shitë prodhimet e tyre bektorale kjo smundje që e ka prek Kosove nuk e ka prek vetem Vitin por e ka prek Kosove. Agjenciani i veterines është tu marr shume ke këte problematik kemi pasur te Hanen një takim special me kryetaret e Komunave por un e kamë perfaqesu kryetarin pershkak se kryetari ka pasur agjent të ngjeshur edhe krejt qka eshte duke u bere nga agjencioni veterines është duke u bërë vaksinimi i kafëshve në zonat e fshatrave kufitare që rrethoj ne kete rast vitin si fsh Buzucik,Lubisht, Debolle, Shashare etje pershak se nuk ka numer të mjaftueshme të vaksinave për shitje nga se që edhe ne nivel të botës eshte vetem një ëëender që prodhon këtë vaksinë se është një smundje e re që Kosoven per her të par e ka prek kjo smundje, per fatë të mir kjo smundje nuk bartet te njerëzit por shkakton dëme të mëdha në ekonomit familjare, agjencioni ka kërkuar nga komunat ne kee rast edhe nga ne qe kafshët të coilat ngordhin që të bëjmë groposjen e tyre në menyren profesionale pa pasur pasoja oëe ambientin dhe pa pasur pasoja për njerëzit, për fat të mirë komuna e Vitisë është një hap përpara ne krahasim me komunat tjera, mirëpo për deri sa në një vendim të ri të agjencionit ne nuk mujme ta hapim tregun e kafeshve as në Viti dhe as kund tjetër prandaj kjo është ne nivel qendror.

**Drejtori z.Nexhmedin Jakupi:** Përshëndetje për Kryetarin, kryesuesin për këshilltarët komunal, drejtoret e ju te pranishem sa i perket ndriçimit publik ne Kabash e tha edhe kryetari që ende nuk e kemi perzgjedhe kopanin e cila procedurat jane vonu pëe shkak të ankesave që jane bë ku ka deshti një proces edhe tash besoj që do të perzgjedhet ajo kompani dhe do të mirrem me mirëmbajtjen e ndriçimit publik do te zgjidhet problemi kemi qen ne vend të ngjarjes e dime situaten, ndersa sa i perket shqetësimit te z.Sejdes në ditën e panairit ne taksit që kane te rezervuar parkingjet ju kemi bërë alternative ne anen e djath të sheshit kemi bisedu me taksista un nuk kame pas as nje vërejtje si drejtor i shërbimeve publike se eshte anku ndonjë taksi.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** I falënderoj te gjithë parafolësit dhe deklaroj që në seancën e VIII të rregullt te Kuvendit Komunal kemi paraparë këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Informatë (raport) i punës së Kryetarit të Komunës dhe organeve komunale për periudhën janar-qershor 2016
3. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C. për vendosjen e një trafo elektrike
4. Raporti i punës Janar-Qershor 2016, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutem?, pasi që nuk ka hedhet në votim për miratim i rendit të ditës: Kush është për miratim? Konstatohet që me votat e të gjithëve u miratua ky rend dite.

**Kryesuesi z.Nami Pira:** Pasi u paraqit një propozim nga asambleisti z.Adnan Imeri, kryesuesi deklaroi që duhet të konsultohemi me zyren ligjore dhe me organet në nivelin qendror, pasi që nuk dëshirojmë që të marrim hapa të cilët mandje do të vinë në kundërshtim me punën të cilën jemi duke e bërë në kuvend disponimi edhe i kryetarit edhe i joni edhe i asambleistëve dhe i qytetarëve të komunes së Vitisë është qin për qin që më mirë ti kthejmë ato prona, dhe me shtinë na në propozim tash për tash që mundën me një kthim masanej e ku ti propozove për mbledhjen e radhës.

**Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti:** Une e thash edhe unë jam që këtë të bëjmë temë diskutimi, e shtimi si rend të pikes edhe u krye mire po mos të bëjmë vendim nga se që në seancën e ardhshme na abrogohet dhe na shenohet si vendim jo ligjor për këtë duhet të konsultohemi me zyren ligjore, edhe unë po ta them që nëse në bëjmë vendim na abrogohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal një kthen por na të hapim rekomandime të përkrahim letrat e Komunes, prandaj na e hapim debatin e kështu me të vertet se kjo është një pasuri e ku kemi dëshirë me e ruajtë si të përgjegjshme për krejt popullatën. Aja nëse e bëjmë vendim është jo ligjor na abrogohet nga se që atë prona momentalisht e udhëheq AKP-ja, gjere sa nuk ka Parlamenti i Kosovës vendim tjetër eventualisht ligji për investime strategjike nëse kalon dhe në kemi investitor e ku në jemi të dëshirë me ruajtë si parqe ata atëherë duhet vetëm me përkthi lëndën.

**z.Adnan Imeri:** Mbi të gjitha nuk po duhet me ra në kundërshtim me fjalet e ku i respektoj fjalet e kryetarit ku thotë që duhet që çdo veprim me marrë në bazë të dispozitave ligjore, unë besoj shumë që ky propozim i imi është i ligjshëm i arsyshëm, nga arsya se unë e kam një vendim të seances së shkurtit të viti 2016, që është i njëjtë me propozimin time dhe ajo vendimi ka dalë si i ligjshëm atëherë pse sot pasmi një vendim jo të ligjshëm, unë mendoj që në duhet të jem të përgatitur nga tash që nëse kur të vij investitori të jemi të përgatitur, unë nuk tërhekem prej propozimit time edhe kërkojmë nga ju nëse ka diçka antiligjore na e shpallim të anuluar ju faleminderit.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Kërkesa e juaj z.Adnan ishte që të hin ky propozim në seancën e radhës edhe këtë do ta shtim për me e diskutu në seancën e radhës.

A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutem?, pasi që nuk ka hedhet në votim për miratim i rendit të ditës: Kush është për miratim? Konstatohet që me votat e të gjithëve u miratua ky rend dite. Konstatohet se me votat e të gjithëve të pranishëmve u miratua rendi i ditës.

### Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Kuvendit Komunal të Vitisë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debatin rrethe procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? Pasi që nuk ka, qes në votim: Kush është që të miratohet procesverbali i

mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal Vitisë? Nga te gjithë asamblastët prezent pika e parë u miratuar.

### **Pika e dytë**

#### **2. Informatë (raport) i punës së Kryetarit të Komunës dhe organeve komunale për periudhën janar-qershor 2016**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Kryetari i Komunës referohet dy herë kuvendit dhe natyrisht sot po ja japim fjalën kryetarit.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** I nderuari Kryesues i Kuvendit, të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal,të nderuar përfaqësues të mediave, shoqërisë civile, OSBE, e ju që jeni prezent.

Ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Statuti i Komunës, kam kënaqësinë që,sot para jush të paraqes raportin e gjashtë mujorit të parë të punës për vitin 2016, ne kemi mbaj edhe tubimin me qytetar e për raportin 6 mujor, sot do të ju informoj për së afërmi për të arriturat tona gjatë këtij 6 mujori, për planet tona deri në fund të vitit 2016 si dhe me interesimin më të madh të dëgjojë nga Ju propozimet dhe sugjerimet se si së bashku mund të bëjmë një punë edhe më të mirë në periudhën e mbetur të vitit 2016 dhe në të ardhmen. Pra, sot do të do të diskutojmë për:Punën tonë brenda gjashtë muajve të parë të këtij viti,Sfidat me të cilat jemi përballur, dhe Punët dhe planet që na presin deri në fund të vitit 2016. Të nderuar këshilltarë para vetës keni raportet detale të çdo drejtorie veç e veç, më lejoni që shkurtimisht të bëj një përmbledhje të punës sonë 6 mujore, sfidat me të cilat jemi përballur dhe planet që na presin.

Por, para se të paraqes këtë raport timin të shkurtër, dëshirojë që me sinqeritetin më të madh institucional dhe qytetarë të ju falënderoj për mbështetjen dhe kontributin tuaj gjatë punës sonë të përbashkët gjatë tërë kohës.

Parim i qeverisjes sonë te deritanishme është qeverisja me qytetarët, dhe për qytetarët. E në saje të këtij parimi kemi një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse, gjë që është vlerësuar nga mekanizmat e ndryshëm monitorues ndërkombëtar si dhe vendore duke filluar nga OSBE që ju ka nderuar me mirënjohje për punën e suksesshme të bërë si Kuvend Komunal, pastaj organizata GAP që ka renditur komunën tonë në mesin e komunave të para për sa i përket përmbushjes së premtimeve të dhëna. Vlerësime pozitive për qeverisje lokale kanë dhënë edhe organizata si BIRN , KDI etj.

Falë kësaj qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse dhe në saje të punës së palodhshme është ndërtuar edhe një raport i thellë bashkëpunimi edhe me misionet diplomatike ndërkombëtare në Kosovë si me Ambasadat e vendeve të Kuintit, Zyrën e Bashkimit Evropian , KFOR-in OSBE-në dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtare, bashkëpunim ky që ka rezultuar edhe me projekte të ndryshme nga donatorët dhe organizatat e huaja; Komisioni Evropian, OSBE, Fondacionin Luksemburg Kosova, DEMOS, GIZ-in Gjerman etj, si përmes investimeve ne projektet e ndryshme ashtu edhe përmes ngritjes se kapaciteteve tona.

Këto projekte të përbashkëta që kemi realizuar me donatorë të ndryshëm e që janë me dhjetëra pos që kanë mbuluar pjesën e shkurtimeve buxhetore që kanë ardhë si rezultat e vendimeve nga qendra, ato dukshëm kanë ndikuar edhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve pasi janë rregulluar parqe, trotuare, ujësjellës, është rivitalizuar dhe riaktivizuar kinemaja e qytetit etj.

Në rritjen e transparencës së punës së qeverisë komunale, ngritjen e brengave dhe nevojave të qytetarëve, është i pakontestuar roli i OJQ-ve dhe mediave aktive në komunën tonë: gazetarëve të mediave të ndryshme qendrore, mediave lokale elektronike (radiove, TV), portaleve, etj., të cilat i falënderoi për bashkëpunim korrekt.

Qeveria komunale edhe këtë vit ishte e përkushtuar qe te ofroj shërbime me cilësore publike, te rris kualitetin e arsimimit, te ofroj shërbime me te mira mjekësore, te ndikoj ne rritjen e mirëqenies se përgjithshme te qytetareve tone përmes investimeve direkte ne bujqësi dhe përmes krijimit te një ambienti me te mire për zhvillim ekonomik, te krijoj një ambient me te

pastër për jetesë përmes mirëmbajtjes dhe rritjes së hapësirave të gjelbërta në gjithë territorin e komunës, dhe gjatë këtyre 6 muajve, është bërë punë e konsiderueshme në të gjithë sektorët me një qëllim të vetëm- që të jemi në shërbim të qytetarëve dhe të përmirësohet kualiteti i jetës së qytetarëve të komunës sonë, që ishte jo vetë premtim por edhe zotim i dhënë gjatë zgjedhjeve të fundit që qeveria e udhëhequr nga unë do të jetë në shërbim të qytetarëve.

Prandaj me të drejtë mund të them se zotimin e dhënë para qytetarëve që parimet mbi të cilat do të udhëheq komunën e që janë :zbatimi i pa negociueshëm dhe i përpiktë i ligjit, qeverisje transparente dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve, përfshirja e qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendim-marrje, shpenzimi racional dhe efikas i buxhetit komunal, administratë e përgjegjshme, rritje e nivelit të bashkëpunimit me organizatat e të rinjve, grave, personave me nevoja të veçanta, bujqve, artistëve, sportistëve, studentëve, etj, bashkëpunim më i ngushtë dhe partneriteti me donatorët dhe organizatat e huaja me qëllim të absorbimit të projekteve dhe investimeve në komunë, bashkëpunimi i ngushtë me qeverinë qendrore, agjencionet dhe mekanizmat tjerë të nivelit qendror janë përmbushë në shkallën qind për qind.

Puna ime si kryetar dhe e qeverisë komunale është fokusuar në prioritetet si :Zhvillimi i bujqësisë ,shëndetësia, arsimit, kultura dhe sporti ,Infrastruktura lokale ,shërbimet publike,zhvillimi ekonomik, përkujdesja për shtresat e varfra dhe grupet e marginalizuara, bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët ,mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës andaj, më lejoni që shkurtimisht të përmend disa të arritura kryesore në fushat që i përmenda më lartë:

**BUJQËSIA:** Janë procesuar 1571 aplikacione për subvencione, janë shpërnda subvencione për: makineri, bletari, përpunim të mishit, fidane të pemëve në bashkëpunim me Fondacionet dhe shoqata e organizata të tjera, janë shpërnda fidane të mjedrës për 40 fermerë, janë shpërnda 35 serra, janë shpërnda bimë mjekuese dhe makina bujqësore, janë konfiskuar 70m3 dru dhe janë bërë 122 fletëparaqitje për dëme në pyje, është hartuar Plani Veprimt për Mbrojtjen e Pyjeve.

**ARSIMI:** Revitalizimi i 8 shkollave, ka edhe shkolla të reja që janë tu ndertu ka edhe shkolla me donacione të reja që janë tu rivitalizu, kalueshmëria e testit për klasët e nënta 73.41%, është organizuar me sukses testi i maturës, rregullimi i infrastrukturës nëpër shkolla, fusha sportive nëpër shkolla, organizimi i garave të diturisë, sukseset e nxënësve nëpër gara të ndryshme.

#### FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK

Pregaditja e të gjitha projekteve kapitale jemi në rrug të mire edhe visjet rrethe investimeve kapitale që në kohe të arrim natyrisht me I shfrytëzimi mjetet përshkak edhe projekti i fundit vetem ka shku, aplikimi për Zonën Ekonomike- Budrigë e Epërme, trajnimi i më shumë se 60 biznese në menaxhim biznesi, mbështetja e bizneseve për aplikim tek donatorët, mbështetja në hapjen e fabrikës së tekstilit nga investitori gjerman (hapja e më shumë se 500 vendeve të punës), mbështetja e investitorëve për investime në komunë

**KULTURË, RINI DHE SPORT** - Hapja e kinemasë 3D dhe shfaqja e 3 filmave, riaktivizimi i Teatrit të Qytetit, hapja dhe aktivizimi i Qendrës Rinore, subvencioni i 14 shoqatave, klubeve sportive, etj, shënimi i ditëve me rëndësi dhe organizimi i festivaleve dhe panairove, realizimi i aktiviteteve inovative: ekspozita, panairë, puntori, realizimi i projekteve nga donatorët, realizimi i të hyrave vetanake 105.3%.

**URBANIZEM DHE MBROJTJE TE AMBIENTIT** - Shqyrtimi i 16 kërkesave për leje ndërtimore, shqyrtimi i 21 kërkesave për pëlqim urbanistik, shqyrtimi i 15 kërkesave për kushte urbanistike, pastrimi i ambientit në tërë komunën“Ta pastrojmë Vitinë”, shënimi i datave me rëndësi për ambientin (dita e tokës, dita e ambientit, etj), vizita të shumta në terren

**SHERBIMET PUBLIKE** - Hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm, hartimi i Planit për Eficiencë të Energjisë, rregullimi i ndriqimit publik në qytet dhe fshatra, pastrimi i lumit Moravë, Letnicë dhe prockave, eliminimi i deponive ilegale nëpër fshatra, mirëmbajtja verore



dhe dimërore e rrugëve, mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujësjellësve, sinjalizimi i rrugëve (horizontal dhe vertikal).

SHENDETSIA - Përrurimi i objektit të ri të QMF në Pozheran, fillimi i ndërtimit të ambulantsë në Skifteraj, revitalizimi i kulmit të QKMF në Viti, rregullimi i hapsirave tek objektet shëndetsore, furnizimi i QKMF me aparaturë mjekësore, shënimi i ditëve me rëndësi për shëndetin public, organizimi i vizitave nëpër institucione publike dhe lokalitete.

KADASTER, PRONE DHE GJEODEZI - Shqyrtimi mbrenda afatit ligjor i 5035 kërkesave për shërbime, avancimi dhe modernizimi i shërbimeve kadastrale, tërheqja e investimeve dhe granteve nga donatorët e huaj (USAID, DEMOS), realizimi i të hyrave 116%, pregatitja e 8 propozim-vendimeve për Kuvendin Komunal.

INSPEKSIONI - Inspektimi i objekteve shkollore dhe shëndetësore, analizat e ujit të pijshëm në të gjitha shkollat, qerdhe, cdo 3 muaj, pranimi teknik, higjieno sanitare të 50 biznesve të reja, inspektimi dhe ndërprerja e ndërtimeve pa leje, inspektimi i kafshëve për sëmundje ngjitëse, inspektimi i bizneseve, asgjësimi i kafshëve të sëmuara.

ADMINISTRATA - Shërbime më kualitative për qytetarë, është zvogëluar koha e pritjes për shërbime, ka mbështetur në organizmin e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, komiteteve, etj, janë lëshuar 22,309 dokumente.

**Projektet Kapitale nga buxheti i Komunës:**

Nr	Projekti	Shuma	Pershkrimi
1	Asfaltimi i rruges Sllatin e Ulet Sllatin Eperme	84,982.72	Faza e implementimit
2	Asfaltimi i rruges fshatin Lubisht	122,527.50	E perfunduar
3	Asfaltimi i rrugeve Rurale	299,322.88	Faza e implementimit
4	Rregullimi i rrugeve me zhavor	39,248.80	Faza e implementimit
5	Rregullimi i fushave sportive (Goshic, Ramjan )	23,242.00	Faza e implementimit
6	Rregullimi i rrethojave te shkollave (Remnik,Kabash,Zhiti,Terpez)	14,743.75	Faza e implementimit
7	Renovimi i shkollave	44,444.44	Faza e implementimit
8	Ndertimi i Ambulantes Skifteraj	24,029.54	Faza e implementimit
9	Renovimi i Ambulantave	14,792.00	Faza e implementimit
10	Ndertimi i shkolles fillore faza e II Begunc	136,232.00	Faza e implementimit
11	Rregullimi i Kanalizimeve	120,000.00	Faza e Pergatitjes
12	Ndertimi i Trotuarit dhe ndriçimit publik	50,000.00	Faza e Pergatitjes
13	Rregullimi i hapsirave gjelbruese - publike	20,000.00	Faza e Pergatitjes

**Projektet Kapitale nga niveli qendror të bashkëfinancuara me buxhet të komunës**

Nr	Projekti	Shuma	Pershkrimi
----	----------	-------	------------

1	Asfaltimi i rruges Devaj - Radivojc	125,000.00	Faza e Tenderimit
2	Asfaltimi i rruges Terpez - Ballanc	155,000.00	Faza e Tenderimit
3	Asfaltimi i rruges Remnik - Nasal	117,000.00	Faza e Tenderimit
4	Asfaltimi i rrugeve rurale Viti (Projekt II vjeqar)	509,087.75	Faza e Tenderimit
5	Asfaltimi i rruges Stubell te Eperme	100,000.00	Faza e Tenderimit
6	Renovimi i shkolles se pare shqipe Stubell	26,960.80	Faza e implementimit
7	Rregullimi i shetitores nga Kisha ortodokse deri te rampa Kabash	40,000.00	Faza e Tenderimit
8	Rregullimi i infrastruktures te stacionit te autobuseve Viti	24,000.00	Faza e Pergatitjes
9	Ndertimi i shkolles fillore Pozheran	2,100,000.00	Faza e Tenderimit
10	Ndertimi i Palestres Sportive Viti	1,600,000.00	Faza e Tenderimit
11	Rregullimi i qendres Rinore	25,000.00	E Realizuar
12	Renovimi i shtepis se Kultures	200,000.00	Faza e Pergatitjes
13	Asfaltimi I Rruges Viti-Korbliq-Kaqanik (faza e pare)	350,000.00	Faza e Pergatitjes

**Projektet kapitale të financuar nga donatorët e huaj**

Nr	Projekti	Shuma
1	Verifikimi i Pronave Komunale (DEMOS)	5,400.00
2	Aftesit per punesim rural (DEMOS)	1,200.00
3	Perfundimi i projektit ujesjellsi 5 fshatrat (CDI)	100,203.00
4	Ujesjellsi ne Fshatin Smire dhe Verban (CDI)	540,000.00
5	Furnizim me dy Makina per Shendetesin (Qeveria Japoneze)	56,900.00
6	Zhvillimi i Bujqesis ne Komunen e Vitise (IKC)	34,310.00
7	Bashkefinansim me Fondacion Kosovo Luksemburgu per 3 fshatra (Budrik, Skifteraj,Radivojc)	200,000.00
8	bashkefinansim me Fondacion Kosovo Luksemburgu per bizneset fillestare dhe ekzistuese ne Komunen e Vitise	136,238.00
9	Sherbime Keshillemore dhe trajnime per fermeret e Komunes se Vitise (IADK)	4,100.00
10	Investimet ne Kuzhina te shkolles "Deshmoret e Vitise" (IADK)	10,770.00
11	Programi per te drejtat Pronesore (USAID)	200,000.00
	<b>TOTAL</b>	<b>1,289,121.00</b>

**Sfidat:** Sfidat me të cilat jemi përballuar në qeverisjen gjatë kësaj periudhe janë probleme që kryesisht lidhen me nivelin qendror dhe mungesës së buxhetit ndër to janë: Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Pozheran që është kompetencë e MASHT-it dhe që është në fazën e tenderimit, ndërtimi i palestrës sportive që është kompetencë e MKRS-së , rregullimi i lumit Morava me përroskat përreth që është kompetencë e MAPH-së, mungesa e pronave komunale për zhvillimin e bizneseve – problemet e AKP-në, Uji i pijshëm në: Sllatine të Epërme, Sllatinë të Poshtme, Sodovinë Jerlive, Sodovinë Cerkezëve, Terstenik, Smirë, Vërban, Zhiti, Skifteraj, Beguncë –sfidat që kanë dalë shkaku borgjeve të grumbulluara nga qeverisja e kaluar.

**Planet:** Me gjithë këto sfida si dhe problemet me buxhetin e shkurtuar për investime kapitale jemi zotuar që edhe në të ardhmen përmes bashkëpunimit me qytetarë , donatorë si dhe mekanizmat tjerë vendor dhe ndërkombëtar tjerë të punojmë që të plotësojmë nevojat e qytetarëve në mënyrë që ata të kenë jetë sa më të mirë .

Për këtë duhet edhe mbështetja e juaj gjë që kryesoi se nuk do të mungoi.

Para se t`iu falënderoi për përqendrimin e juaj në diskutimin tim edhe njëherë ju bëj me dije se do të jem këtu së bashku me ju të dëgjoj çdo propozim, vërejtje apo sugjerim në raportin e paraqitur sot dhe për punën tonë të deritanishme.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Falënderon kryetarin për shtjellimin e raportit 6 mujor të punës se suaj me dikasteret tuaje, unë e hapi debat rreth kësaj pike.

**znj.Vjollca Kadolli-Halili:** Përshëndetje për Kryetarinm te nderuar koleg këshilltar, te nderuar drejtor, e ju të pranishmit, raportin gjashte mujor të kryetarit dhe të organeve të komunës mendoje se është nje raport permbajtësore kujane të permbledhjura të dhenat e të gjitha punëve të ekzekutivit dhe kryetari për këtë periudhe dhe me të rëndësishmet jane që ceken në kete raport, menagjimi i paras publike, realizimi i objektivave në bazë të planifikimit gjashtë mujor nga secila drejtori veq e veq, shërbime më cilësore të stafint ndaj qytetarve në komunes sonte si dhe sfidat nga disa drejtori të cilat janë paraqite dhe kane percjellur në kryerjen e detyrës dhe obligimeve, unë do të ndalem të disa drejtori ku puna e drejtorive është përshendetur pëe seriozitetin dhe realizimin e objektivave të tyre do të fillojm nga drejtoria e administratës së pëegjithëshme që përkunder sfidave që ka paraqitur megjithatë ka realizuar objektivat të cilat kanë dalurë nga plani i punës së drejtoris për vitin 2016, sa i për kete drejtoris së financave për pos objektivave të arriturave eshte per tu vleresupërgaditja e një planit të veprimit nga komisioni kompotent pëe rritjen e inkasimit të tatimit në pronë që dijet se paraqet edhe bazen e të hyrave vetanake komunale dhe drejtperdrejte atakon ngritjen e mirqenjes së qytetarve tanë për investime gjithë ashtu edhe lista e projekteve të realizuara të atyre të cilat janë realizim e siper si dhe atyre që do të realizohen flet më se miri për një pune të suksesshme dhe shpres dhenese të ekzekutimit të drejtoria e arsimit është për tu vlarsuar puna e kësaj drejtorie sidomos me aktivitetet që jane ndërmarr për ngritjen e interesimit të nxenesve në testin e arritëshmeris së maturës si dhe organizimin e debateve të ndryshme mbi dukurit negative në shoqeri, drejtoria e bujqesis subvencionet e bujqesit që ndikojn në gjendje ekonomike të qytetarve tan ku per kete gjashte mujore jane shpërnda mjedra, serra si dhe paisje që sherbejn pëe bujqësi, drejtoria per shërbime publike dhe emergjenc ka bë gjithashtu shume punë që ndikojn në letesimin e jeteës së qytetarve duke filluar nga shtrurja e rugeve me zhavore eliminimi i deponive ilegale mirëmbajtja e ambientit mbjellja e luleve dekorative, ndriçimi publik si dhe rregullimin e pjerrinave për personat me aftësi të kufizuar, drejtoria pëe kultur rinis sporte ky raport flet për një përformancë tejet pozitive ku vitia është bërë vend takimi i intelektualve të artit, promovim librash, kultur sport realizimi i detyrave të kësaj drejtorie shihen edhe shënimi i ditëve të caktuara, realizimi i manifestimeve të ndryshme si manifestimi i "Flakadanit të Karadakt", dhe i "2 Korrikut", sukseset e kësaj drejtorie që duhet të permenden dhe të vlerësohen jane edhe riaktivizimi i kinemas dhe i teatrit aktivizimi i qendres së rinis e

shume projekte të tjera të cilat ne baze të anketimit me qytetar të komunes së Vitis nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, UNDP-ja, USAD, ka radhitur Komunen e Vitise të paren me knaqeshmerin të aktiviteteve, të gjitha këto që i permenda jane projekte që qdo ditë preken nga qytetaret tane keshtu që munde të thëme se Kryetari i Komunesë së bashku me ekzekutivin ne këtë gjashte mujore kane arrit që ti permbushe të gjitha detyrat dhe obligimet duke respektuar Ligjin per vetqeveerisje Lokale, dhe plani e punes gjashte mujor ju faleminderit.

**Znj.Mirlinda Sadiku:** Përshëndetje per Kryetarin e per ju të pranishmit, fillimish Urata Rames i dëshiroj suksese një përfaqësim dinjitoz të shtetit të Kosovës, pse jo edhe të na sjell medalje, me te vertet një raport vuliminoz sipas obligimit ligjor që e ka Kryetari per me na raportu dy herë në vitë, pyetja ime është qka ndodhi me operatorin i cili prehu 200 pisha në fsh Terpezë, qka ndodhi me bursat e studenteve që ndahen ne kuadër të zyres së kryetarit, a i ka marr parasysh rekomandimet të dalura nga njësia e auditorit të brendeshem ku nga tri auditive që i ka kry auditori i brendëshem kan rezultuar me 14 rekomandime, është vënë vërejtje te zyra e personelit e citoj vërejtje të cilen e ka dhën vete zyra e personelit, citoj: efikasiteti dhe azhuriteti i punës së sektorit të gjendjes civile kishte me qen edhe me i madhe po mos te mungonte hapësira e nevojshme për pune paisje elektronike inventari, sa po i patem pasqyrat financiare të cilat i prezantoj drejtori i financave aty rezultoj që jane ble diku rrethë 10 kompjutera është bler inventar qka po ndodh me objektin qysh në fillim të mandatit jeni interesu keni trukit në shume dyer në vende të caktuar ku duhet pëe këte objekt si që thot kolegu nga Smira që do ta kryem mandatin e nuk do të shkojm në at objekt të ri, teke zyra e financave drejtor a mendon që ka rezultu edhe e suksesshme ndarja e faturave ku i ki nda diku prej buxhetit komunal rrethe 5000 euro, për shpërndarje e faturave në forme të postës u paguar ky shërbime ndersa ka rezultuar që vetem 10000 euru me shume jane arkëtu, dmth edhe për kunder asaj që eshte bëre edhe falja e borgjit, unë po flas pëesonalisht nuk e kam marr faturen e tatimin në prone, investime kapitale 5 vite te fundit Vitia po i premtohet një palester sportive po ndertohet edhe ne Zhegër të Gjilanit e ne hala jemi në pritje, sipas informatave të cilat i kame te verifikuar shume mir në fillim ka qen 3 milion e 600 mije euro, tashe u reduktu ne 1 milion e 500 mije euro, po e shiheni ende nuk ka filluar palestra sportive e dime që kemi një numer të madhe të klubeve po palester ende nuk kemi, arsimi me merr mednja që shtylla më e rendesishme e një shteti drejtor do të ishte mir që në planin e punes dhe po ashtu në bashkëpunim edhe me psikologen të mirren parasysh që ata nxansa të cilet janë pjesë e veprave të ndryshme delikuate të mirren në konsiderat në menyrr që ata njerz të riintegrohen dhe po ashtu qe ata nxanës që mos ti pëeserisin ato vepra, po ashtu te rivitalizimi i shkollave nuk me ra ne sy rivitalizimi i kulmit të shkollës në fsh. Skifteraj, dmth renovimi i shkollave ishte shuma dikune 4 e 4000 mije euro, me sa e di un nese nuk gaboj e buxhetin kur e kemi aprovu ka qen 70000 mije euro, pse nuk eshte përmend te drejtoria komunale e arsimi se eshte sfid që në Pozharan nuk po mundet të ndertohet nje qerdhe ose nuk po munde të rifunksionalizohet shkolla në Qifllak që e ka kërkuar edhe grupi i grave, drejtori i shendetesis a do të jemi të sigurt që femija tonë do të pine ujë të pastert nuk do të jet i kontaminuar, sipas asaj raporti që e thave që me 31 Mars veq ka skaduar kontrata a eshte ripërtri nese nuk eshte ripërtri pse nuk eshte ripërtri, drejtoria e inspeksionit a do ti kushtoni vëmendje shkollave sidomos objekteve afariste sidomos shitoreve që janë afer shkollave në menyrr që të vërtetohen që mos të shiten gjana ushqimore me afat të skaduanë apo që nuk i plotësojn kushtet higjienike, drejtoria e bujqësis duhet të mendohet me shtrimin e rrugeve me zhavorr si pas asaj që kame nga kryesuesi i fshatrit Skifteraj vetem 20% në fshatin Skifteraj jane te shtrume me zhavore e dime që bujqesia është një lami shume e rëndesishme si dhe me intereson ta dije sipas kontratës të nënshkruar me fondacionin Kosovë-Luksemburg në aksin rrugorë Radivojc-Budrik-Skifteraj eshte pas mendu me bë një minitreg të vogël sad jane 19 serra kanë prodhime ka specia,domate e artikuj të ndryshëm mire po nuk kane mundesi të i qasen tregut sidomos grat të cilat punojn naper shpi.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Falemnderi për pyetjet e parashtruara, dua të ja perkujtoj Mirlindes që un jame i detyruar që të punoj për krejt territorin e Komunës së Vitise jo me ba nderje me lokalitete, kjo na shtyn me të ndarje e buxhetit në krejt fshatrat e komunes se kjo është patjetër, pyetjen që e beri Mirlinda për operatorin e kemi ndërpre kemi ndërhy se bashku me fshatin për shkak se janë meritat e fshati Terpez që ka reaguar me kohë dhe ne i kemi dhënë alternativa për shkak punës profesionale operacionale teknike agjencioni i pyjeve të kosovës ne me kompetencat e tona nuk mujme ta ndalim por natyrisht e kemi ndal një shkatërrim të tillë të asaj paralele ekonomikopujore të pishave gjegjësisht në këtë raste dhe i kemi dhënë alternativ propozimit që ka pas mirëkuptime ka pas mirëkuptim nga agjencioni me fshatin, me operatorin, prandaj un mendoj që e kemi rregullu me kohe e kemi gjetë zgjidhje, të auditori i brendëshem është mir kuvendi ju kam than edhe shumë her zyre e kryetarit sa her që do me i ftu ne takime e biseda për shkak se edhe zyra e kryetarit sikur drejtorat e kane me raportu edhe pse auditori i brendëshem ne komitet e ka për detyr ligjore me raportu prandaj, por edhe un një gjë po ta them që auditorin e brendëshem janë induraju që bashë prej Kryetarit të Vitisë që defektet me i nxjerr deri në fundë qdo drejtori, dhe rekomandimet për qdo drejtori i kemi po ta jap një shembull Drejtoria e shëndetësis rekomandimet e auditorit të mbrendëshem i ka shqyrtu para tri dite e ka pasur takimin për rekomandime dhe plane të veprimit për sanimin e atyre të mundeshve se kemi rekomandime që nuk mujmi momentalisht, dhe secila drejtori me rekomandimet e auditorit të brendëshem në rend të par mirret, sa i perket vërejtjeve të zyrës së personelit hiq me mir nuk i ka kushtet Kryetari i Komunës po në keto kushte kemi arrit në krejt performancat momentale që tri vjet me marr vendin e parë në keto kushte që është duke punuar Kryetari i Komunës edhe që punon Komiteti për Politik dhe Financa që janë tu punu edhe Nënkryetari e Kryesuesi i Kuvendit ne i dime krejt kushtet në të cilat jemi duke punuar se jemi ketu bashke por në keto kushte kemi arrit që me pas rezultate dhe krejte kuintit me qen ambasadorit një nga një dhe ne na dhan projekte atje jemi tu keshyre individualisht me kriju hapësira por hapësire e komunes së re dhe objekti të ri nuk është mir me ja veshe kësaj qeverije adine pse se jame tu të përpjekje me komisionin evropian është jo interes tash me ngrit zerin në publik po me letra jemi tu punu shumë besoj që kjo komune me ne funde se ajo është që 5 a 6 vite nuk është sot, besoj shume që ne kete vit do të instalomi se kushtet teknike i kemi, kemi me pas probleme juridike me objektet e tjera shume shpejt do ta shifni se kame punu në at drejtim, të shpërndarja e faturave është drejtori i drejtoris këtu është ku do të përgjigjet drejtori për kete, e sa i perket kompjuterëve ajo është evidente secila zyre që ka marr kompjutera ajo është e shenuar janë të ivenditume dhe asetet janë aty është personeli për regjistrimi e asetëve dhe ketu nuk ka leshim, të investimet kapitale të palestrat kisha pas qaf me tha un e kame kompotenc palestren e keshtu e ashtu, 3 milion e 600 duhet me e argumentu kur ta thush kete se kjo nuk u kan kurr, un jame kryetar i komunes du me qen i përgjegjeshem ketu ka këshilltar që e din kete 700 mije euro kan qen të ndarura për palestren me dokumenta merre informaten dhe raportin e vitin 2013, ku janë 700 mije euro të ndame, 1 milion e 600 është nuk ka qen kurr 3 milion e 600, kane qen 700 mije të planifikuara por për dy vite, se muj me than un që e kame rrit a po diqka tjetër po shkolla e Pozharani është rrite planifikimi për buxhet i shkollës së Pozharani është rrite, e pyetja për rivitalizim munden mu nda 70 për tenderimi 48 se keto nuk janë qështje të rregullave të ekonomis së tregut, pyetje tjetër ishte rientegrimi i delikenteve ketu përgjigjet drejtori i arsimit pasi që besoj që jep përgjigjeje me adekuate, mire po kjo është obligim i joni me u marr me ta si shoqëri edhe si institucione kemi klas speciale paralele un e di edhe i kame vizitu shkollat edhe të shkolla "Bafti Haxhiu", pyetje ishte qerdhja në Pozharan, nuk kemi pas premtim as planifikim për qerdhen në Pozharan duhet me e shiku nese kemi mundesi me e arrit ne jemi ketu mire po premtim nuk kam pas për kete, pyetje ishte të uji i pijes, nuk është e vertet që kane pije uj të pa kontrolluar e uje jo të shëndetshëm shume shumë kemi bërë në këtë drejtim edhe ti e dinë se me shëndetin publik zyren kemi nënshkrua dhe jemi në vazhdimisht

sigurisht çështjet janë te kryem edhe për kete mandat do të punojmë që ujë të ketë sa më të pastërt sa me te kontrollime për ata kemi folur edhe me herët.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Kryetar mi dhavë pergjigjejet ne pyetje okej mire po që thave fjalen lokalizem i shprehur apsolut nuk qëndrone gjithë këta njerze i kame dëshmitar që kame ngritqeshtje per Pozharan për asfalt te Lubishtës, per Smire e muj me than për të gjitha lokalitetet ne fusha më të ndryshme prandaj ajo nuk qëndrone.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Mirlinde atëherë po te komplementoj se ja ke arrit asfaltin e Lubishtes e kemi shtru e kemi bë shume mir dhe ka qen shume të kënaqur u bë një zgjerim i rrugës, u rregullu se bashku me sheshin atje.

